

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

për

**FUNKSIONIMIN E MEKANIZMIT KOMBËTAR TË REFERIMIT PËR VIKTIMAT
DHE VIKTIMAT E MUNDSHME TË TRAFIKIMIT TË PERSONAVE**

ndërmjet

MINISTRISË SË BRENDSHME

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA

PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE PËR MIGRACIONIN (IOM) – TIRANË

ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE “WORLD VISION” – TIRANË

ORGANIZATËS JO-FITIMPRURËSE “ARIS” – TIRANË

**ORGANIZATËS JO-FITIMPRURËSE “TË NDRYSHËM DHE TË BARABARTË” –
TIRANË**

QENDRËS KOMBËTARE PRITËSE PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT-TIRANË

**ORGANIZATËS JO-FITIMPRURËSE QENDRA PSIKO – SOCIALE “VATRA” -
VLORË**

ORGANIZATËS JO-FITIMPRURËSE “TJETËR VIZION” - ELBASAN

Bien dakord për sa më poshtë:

NENI 1

Kjo Marrëveshje rregullon funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për identifikim, referim, mbrojtje dhe ndihmë të përmirësuar për viktimat /viktimat e mundshme të trafikimit të personave.

NENI 2 Përkufizime

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. **Trafikim i personave:** sipas nenit 110/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë është “Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit”;
2. **Viktimë e trafikimit (VT)** : sipas shkronjës “e” të nenit 4 të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “*Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore*” është personi objekt i trafikimit të personave;
3. **Viktimë e mundshme e trafikimit (VMT):** në këtë dokument është personi për të cilin/të cilën institucionet/agjencitë shtetërore dhe jo shtetërore përgjegjëse për identifikim fillestar gjykojnë se mund të jetë trafikuar;
4. **I/e mitur/Fëmijë:** në përputhje me legjislacionin shqiptar penal dhe civil, është çdo person nën moshën 18 vjeç;
5. **Strehëzat/qendrat për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit:** janë institucione të përkujdesit social rezidencial dhe/ose jo rezidencial, shtetëror ose jo shtetëror të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për të dhënë shërbime ndihme dhe mbrojtjeje për personat viktimat të mundshme të trafikimit, viktimat të trafikimit dhe persona në rrezik trafikimi. Strehëzat/qendrat mund të jenë të hapura ose të mbyllura, mund të ofrojnë qëndrim afat-shkurtër ose afat-gjatë; dhe/ose përdoren për rastet e emergjencave ose të mbështetjes për ri-integrim. Qendrat mund të emërtohen pritëse, ri-integruese apo pritëse- ri-integruese. Ofrimi dhe dhënia e shërbimeve në strehëza bëhet në përputhje me VKM nr. 195, dt.11.04.2007, “Për miratimin e standardeve të përkujdesit shoqëror në qendrat rezidenciale për personat e trafikuar dhe në rrezik trafikimi”;
6. **Organizata:** janë ato organizata të shoqërisë civile vendase dhe ndërkombëtare të regjistruara në Shqipëri, përfshirë qendrat e regjistruara për dhënie të shërbimeve rezidenciale dhe jo rezidenciale, të cilat veprojnë në përputhje me legjislacionin shqiptar për

ofrimin e shërbimeve sociale viktimave të trafikimit dhe të cilat përmbushin kushtet e paracaktuara nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale apo institucione të tjera shtetërore si p.sh. Ministria e Shëndetësisë, që u lejojnë atyre të bëhen Palë në këtë Marrëveshje;

7. **Autoriteti Përgjegjës:** është struktura e cila kryen bashkërendimin dhe monitorimin e procesit të referimit për ndihmë, mbrojtje, ri-integrim të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe regjistrimin dhe raportimin periodik të të dhënave për rastet e trafikimit të referuara nga organizata dhe institucione të tjera në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit.

NENI 3 **Qëllimi i Marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është:

- Identifikimi, referimi, mbrojtja, ndihma dhe ri-integrimi i viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit;
- Sigurimi i zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit (miratuar me VKM nr. 582, datë 27.7.2011);
- Përmirësimi dhe forcimi i partneritetit të aktorëve shtetërorë dhe jo shtetërorë për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat apo viktimat e mundshme të trafikimit;
- Përmbushja e të gjitha angazhimeve të poshtë-përmendura, si pjesë e një qëllimi të përbashkët kombëtar të bashkërenduar kundër trafikimit të personave, rritjes së ndërgjegjësimit publik, si dhe përmbushjes së detyrës shoqërore dhe morale të mbështetjes së ri-integrimit të viktimave të trafikimit.

NENI 4 **Parimet bazë**

Veprimet e Palëve nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje do të bazohen në parimet e mëposhtme:

1. Trajtimi i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit duhet të bazohet tek të drejtat e njeriut, të jetë jo kriminalizues dhe i orientuar drejt viktimës;
2. Qasja ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit duhet të synojë fuqizimin e viktimës, respektimin e dinjitetit njerëzor të saj/të tij, rifitimin e besimit në vetvete dhe rifitimin e kontrollit të jetës së saj/të tij;
3. Identifikimi dhe referimi për ndihmë i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit duhet të bëhet në bashkërendim dhe bashkëpunim të plotë me të gjitha autoritetet dhe strukturat shtetërore dhe jo shtetërore;

4. Të dhënat personale të personave të trafikuar do të ruhen dhe do të përdoren në përputhje me Ligjin nr. 9887, të datës 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”¹, si edhe akteve të tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi;
5. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe sigurimi i shërbimeve do të bëhet pa diskriminim në bazë gjinie, race, ngjyre, etnie, gjuhe, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjeje politike, fetare ose filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënie, përkatësie prindërore, përgjegjësie prindërore, moshe, gjendjeje familjare ose martesore, gjendjeje civile, vendbanimi, gjendjeje shëndetësore, predispozicionesh gjenetike, aftësie të kufizuar, përkatësie në një grup të veçantë apo çdo shkak tjetër;
6. Sigurimi i të gjitha shërbimeve për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit do të bëhet në kohën më të shpejtë të mundshme, brenda afateve ligjore dhe në bazë vullnetare, me informimin e plotë dhe miratimin e plotë të viktimës, duke u siguruar që viktimat e rritura të jenë në çdo moment të lira të refuzojnë shërbimet e ofruara apo të largohen nga qendra/strehëza, nëse kështu dëshirojnë, dhe që viktimave fëmijë t’u jepet mundësia të marrin pjesë në vendimmarrjet për çështje që u takojnë atyre;
7. Përparësi do t’i jepet gjithmonë interesit më të lartë të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, sidomos atyre fëmijë;
8. Mbrojtja e të drejtave të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, si e drejta për siguri, për strehim, për privatësi, e drejta për t’u informuar, e drejta për përfaqësim ligjor, e drejta për të denoncuar autorin e veprës penale, e drejta për t’u dëgjuar në gjykatë, e drejta për kompensim për dëmet, për asistencë mjekësore dhe sociale dhe e drejta për t’u kthyer në vendin e origjinës do të garantohen gjatë gjithë procesit të identifikimit, referimit dhe mbrojtjes, si dhe gjatë zbatimit dhe monitorimit të kësaj marrëveshjeje;
9. Përfshirja nga ndjekja penale e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, në përputhje me parimet bazë të sistemit ligjor, për përfshirje në aktivitete të jashtëligjshme si rezultat i situatës së tyre të trafikimit;
10. Mbrojtja dhe mbështetja ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit nuk do të kushtëzohen në asnjë moment nga bashkëpunimi i tyre me drejtësinë.
11. Dhënia e ndihmës së duhur do t’u sigurohet viktimave me nevoja të veçanta, sidomos për ato me aftësi të kufizuara, sëmundje, çrregullime psiko-sociale apo shtatzëni;
12. Kujdes i veçantë profesional, me bazë interesin më të lartë të fëmijës, do t’u sigurohet viktimave fëmijë nga një staf i trajnuar posaçërisht për këto raste, i cili njeh mirë të drejtat dhe nevojat e veçanta të viktimave fëmijë, si dhe çështjet gjinore;
13. Të gjithë Palët do të garantojnë të drejtën e autorit mbi materialet të prodhuara nga Palët. Përdorimi, riprodhimi, ndryshimi, publikimi dhe shpërndarja e materialeve do të bëhet vetëm me leje të Palës që ka prodhuar materialin.

NENI 5

Angazhimet e Palëve

Në përputhje me Nenet 2, 3 dhe 4 të kësaj Marrëveshjeje, Palët angazhohen si më poshtë:

¹ Fletorja Zyrtare: Viti 2008, Nr. 44, Faqe 2001; data e botimit: 01-04-2008.

A) Ministria e Brendshme:

1. Të zbatojë “Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit” të miratuar me VKM Nr. 582 datë. 27.07.2011, aneks i kësaj Marrëveshjeje, për të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me intervistimin, identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
2. Të harmonizojë terminologjinë e të gjitha akteve të saj nënligjore të lidhura me viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit me VKM Nr. 582, datë 27.07.2011, aneks i kësaj Marrëveshjeje;
3. Të kryejë identifikimin, pritjen dhe intervistimin paraprak të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe të bashkëpunojë me Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje sipas PSV për referimin e tyre pranë familjeve apo tek qendrat pritëse për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, me qëllim akomodimin, mbrojtjen, rehabilitimin, ri-integrimin apo riatdhesimin e ndihmuar të tyre (në rast të viktimave të huaja), duke angazhuar strukturat përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe drejtoritë në qarqe;
4. T’u japë ndihmë fillestare të gjitha viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, sipas nevojave të tyre, gjatë pritjes fillestare, sidomos në pikat e kalimit të kufirit për plotësimin e nevojave imediate për ndihmë mjekësore, ujë, ushqim, veshmbathje etj.;
5. Të sigurojë që të gjithë personat e identifikuar si viktima të mundshme të trafikimit të intervistohen sa më shpejt dhe në përputhje me nevojat e tyre nga strukturat e policisë antitrafik dhe punonjësit socialë shtetërorë dhe/ose punonjësit socialë të qendrave apo OJF-ve, Palë në Marrëveshje;
6. Të sigurojë, në bashkërendim me Autoritetin Përgjegjës, Qendrat dhe OJF-të e autorizuara që, për rastet me fëmijë të kthyer, fëmijë “inad” apo fëmijë të identifikuar brenda vendit si viktima/viktima të mundshme të trafikimit, që intervistimi i fëmijës të jetë prioritar dhe të bëhet në një vend të veçantë, duke përdorur mënyra të posaçme për fëmijët;
7. Të bashkëpunojë ngushtë dhe nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të vendase për aspekte të veçanta që kanë të bëjnë me pritjen dhe ndihmën ndaj viktimave/viktimave të mundshëm të trafikimit në veçanti të fëmijëve (si shembull mund të përdoret marrëveshja e aplikuar me organizatën ARSIS);
8. Të sigurojë që gjatë intervistimit të fëmijëve viktima/viktima të mundshme të trafikimit, përveç strukturave antitrafik dhe punonjësve socialë ose psikologut të trajnuar për këtë qëllim, të jetë i pranishëm edhe prindi/kujdestari ose përfaqësuesi ligjor i fëmijës, përveç rastit kur ky i fundit dyshohet të jetë i përfshirë në trafikimin e të miturit/miturës sipas PSV;
9. Të pajisë me dokumentet e duhura të identitetit, sipas nevojave të gjitha viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, duke parë me përparësi dhe duke lehtësuar zgjidhjen e rasteve të fëmijëve të paregjistruar;
10. Të pajisë me leje të përkohshme qëndrimi të gjitha viktimat e huaja të cilat dëshirojnë të qëndrojnë në Shqipëri për qëllime reflektimi dhe rehabilitimi, riatdhesimi të ndihmuar apo për të bashkëpunuar me organet e drejtësisë shqiptare;
11. Të marrë masa për të ofruar siguri fizike për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit si dhe për qendrat dhe OJF-të, Palë të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me Ligjin Nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”;

12. Të mundësojë transportim të sigurt dhe masa të tjera sigurie, sipas nevojave për viktimat që bashkëpunojnë me drejtësinë dhe/ose kanë bërë kallëzime penale kundër trafikuesve të tyre, duke i mbrojtur ato deri në përfundim të këtyre çështjeve penale apo dhe më pas;
13. Të fillojë hetime duke aplikuar edhe metodat speciale të hetimit, si edhe duke marrë masat e duhura për të parandaluar raste specifike të trafikimit dhe ri-trafikimit, si brenda dhe jashtë vendit, bazuar në informata të marra nga burimet e veta apo të dhëna të siguruar në mënyrë konfidenciale nga Institucionet, Qendrat dhe Organizatat që janë Palë në këtë Marrëveshje apo nga kushdo tjetër që është në dijeni të fakteve apo rrethanave që kanë të bëjnë me raste të tilla.

B) Prokuroria e Përgjithshme – Prokuroria për Krimet e Rënda:

1. Të bashkëpunojë me të gjithë aktorët e tjerë Palë në këtë Marrëveshje me qëllim hetimin, procedimin e rasteve të trafikimit të personave, si dhe sigurimin e një mbrojtje sa më efektive për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit në bazë të legjislacionit në fuqi dhe në zbatim të kësaj Marrëveshje;
2. Të caktojë një përfaqësues të përhershëm nga Prokuroria për Krimet e Rënda si pikë kontakti për Mekanizmin Kombëtar të Referimit. Personi i caktuar për këtë qëllim do të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e AP-së dhe Task Forcës për MKR-në;
3. Të sigurojë, në bashkëpunim me Policinë, shkëmbim informacioni të ndërsjellë, në mënyrë që rastet të ndiqen në vazhdimësi dhe informacioni për to të jetë i plotë dhe i saktë, nëpërmjet një sistemi homolog me Bazën e të Dhënave për Viktimat e Trafikimit;
4. Të informojë viktimat për të drejtat e tyre si dhe, në bashkëpunim me Policinë dhe aktorët e tjerë, t'i asistojë ato për të lehtësuar të gjithë procesin e identifikimit, referimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit;
5. Të synojë që, nëpërmjet prokurorëve të Seksionit për Hetimin e Veprave Penale të Trafikimit të Personave dhe Koordinatorit për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, që gjatë gjithë veprimtarisë së tyre, krahas mbrojtjes së viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, të sigurojë edhe bashkëpunimin e tyre me drejtësinë, duke i ndihmuar dhe duke iu ofruar atyre të gjithë informacionin e duhur për përfundimet që ato kanë edhe në rast të një bashkëpunimi të tillë, por gjithmonë duke i informuar viktimat mbi faktin se ato nuk janë të detyruara të bashkëpunojnë dhe se ndihma ndaj tyre do të jepet në mënyrë të pakushtëzuar;
6. Të bashkëpunojë ngushtë me Koordinatorin Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave, si dhe me të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë në luftën kundër trafikimit të personave, duke ndarë me ta të gjithë informacionin e duhur.

C) Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

1. Të zbatojë “Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit” të miratuar me VKM nr. 582 dt. 27.07.2011, aneks i kësaj Marrëveshjeje, për të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me intervistimin, identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
2. Të harmonizojë terminologjinë e të gjitha akteve të saj nënligjore të lidhura me viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit me VKM Nr. 582, datë 27.07.2011, aneks i kësaj Marrëveshjeje;
3. Të miratojë masa legjislative ose masa të tjera për të ndihmuar viktimat/viktimat e

mundshme të trafikimit në rikuperimin e tyre fizik, psikologjik dhe shoqëror, duke siguruar, që ndihma të mos kushtëzohet me gatishmërinë e tij ose të saj për të bashkëpunuar me drejtësinë;

4. Të miratojë rregulla, sipas të cilave viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit të kenë akses në tregun e punës, në trajnimin profesional;
5. Të bashkëpunojë me organizata jofitimprurëse të angazhuara në ofrimin e shërbimeve ndaj viktimave;
6. Të sigurojë që shërbimet të ofrohen mbi bazën e konsensusit dhe informimit, duke marrë në konsideratë nevojat e veçanta të personave në një pozitë vulnerabël dhe të drejtat e fëmijëve në lidhje me akomodimin, edukimin dhe kujdesin e përshtatshëm shëndetësor;
7. Të sigurojë zbatimin e standardeve të kujdesit ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit në qendrat rezidenciale;
8. Të caktojë punonjës socialë shtetërorë ose jo shtetërorë të trajnuar, për të kryer intervistën formale të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit 24/7;
9. Të nxisë ri-integrimin e viktimave nëpërmjet referimeve tek agjencitë shtetërore apo agjenci të tjera për një gamë të gjerë shërbimesh, përfshirë arsimimin, trajnimin profesional, punësimin, strehimin, mjekimin dhe këshillimin, si dhe shërbime të tjera sociale, sipas nevojave dhe interesave të vetë viktimave/viktimat e mundshme të trafikimit dhe fëmijët e tyre;
10. Të bashkëpunojë me aktorë shtetërorë dhe jo shtetërorë antitrafik për të siguruar shërbimet e duhura për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit dhe fëmijët e tyre.

D) Ministria e Punëve të Jashtme:

1. Të zbatojë “Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit” të miratuar me VKM Nr. 582 datë 27.07.2011, aneks i kësaj Marrëveshjeje, për të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me intervistimin, identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
2. Të harmonizojë terminologjinë e të gjitha akteve të saj nënligjore të lidhura me viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit me VKM Nr. 582, datë 27.07.2011, aneks i kësaj Marrëveshjeje;
3. Të referojë rastet e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të ardhura nga autoritetet e huaja;
4. Të trajnojë zyrtarët e saj në Tiranë dhe në ambasada dhe konsullata shqiptare mbi çështje të trafikimit të personave;
5. Të nxisë vendosjen e lidhjeve të qëndrueshme me homologët e huaj dhe OJF-të e huaja të fokusuar tek mbrojtja e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
6. Të bashkëpunojë me autoritetet e vendit pritës për të ndihmuar në identifikimin, mbrojtjen dhe lehtësimin e kthimit të ndihmuar të viktimave të trafikimit;
7. Të shpërndajë materiale ndërgjegjësuese në ambasadat dhe konsullatat jashtë vendit;
8. Të sigurojë nëpërmjet konsullatave për lehtësimin e procesit të regjistrimit të personave të paregjistruar që ndodhen jashtë territorit të Shqipërisë;
9. Të lehtësojë procesin e pajisjes me dokumente identifikimi të shtetasve shqiptarë jashtë territorit të Shqipërisë, në bazë të legjislacionit në fuqi.

E) Ministria e Shëndetësisë:

1. Të zbatojë “Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit” të miratuar me VKM Nr. 582 datë. 27.07.2011, aneks i kësaj Marrëveshjeje, për të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me intervistimin, identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
2. Të harmonizojë terminologjinë e të gjitha akteve të saj nënligjore të lidhura me viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit me VKM Nr. 582, datë 27.07.2011, aneks i kësaj Marrëveshjeje;
3. Të njoftojë Autoritetin Përgjegjës periodikisht për kujdesin shëndetësor të ofruar ndaj viktimave të trafikimit;
4. Të bashkëpunojë me aktorët për lehtësimin e aksesit për shërbim shëndetësor sipas kuadrit ligjor në fuqi;
5. Të ofrojë nëpërmjet institucioneve shëndetësore në nivelin parësor, dytësor dhe tretësor kujdes shëndetësor për viktimat e trafikimit bazuar në sistemin e referimit, me përjashtim të rasteve të urgjencës mjekësore të cilët paraqiten direkt në shërbimin e urgjencës, duke u bazuar në parimet e konfidencialitetit, anonimatit, mos-diskriminimit;
6. Të ofrojë kujdes shëndetësor për viktimat e trafikimit bazuar në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore;
7. Të realizojë identifikimin, trajnimin dhe vënien në funksionim të plotë të sektorëve apo pikave të kontaktit, që do të shërbejnë për bashkërendimin e ndihmës së duhur shëndetësore për viktimat e trafikimit në strukturat lokale të shëndetit publik (ASHR/DRSH/DSHP);
8. Të trajnojë/informojë punonjësit e shëndetit që janë në kontakt me viktimat e trafikimit mbi çështjet e anti-trafikimit;
9. Të pajisë nëpërmjet ISKSH-së me librezë shëndetësore viktimat e trafikimit sipas akteve ligjore apo nënligjore të miratuara për këtë qëllim;
10. Të ofrojë shërbimet e testimit dhe këshillimit për HIV/AIDS dhe Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme (IST) nëpërmjet programeve të veçanta me anë të strukturave lokale të Shëndetit Publik, përmes Qendrave të Testimit dhe Këshillimit Vullnetar Konfidencial për viktimat e trafikimit;
11. Të vlerësojë nivelin e mbrojtjes imunitare ndaj sëmundjeve infektive të parandalueshme nëpërmjet vaksinimit dhe të ofrojë vaksinimin sipas protokolleve dhe gjendjes së çdo individi në strukturat lokale të Shëndetit Publik (ASHR/DRSH/DSHP) për viktimat e trafikimit;
12. Të zbatojë programet e depistimit për sëmundje dhe faktorë risku nëpërmjet strukturave lokale të Shëndetit Publik (ASHR/DRSH/DSHP) për viktimat e trafikimit;
13. Të sigurojë ndjekjen e rasteve të viktimave të trafikimit të çrregullimeve të shëndetit mendor nga mjekë psikiatër sipas një grafiku dhe protokollit të përcaktuar rast pas rasti;
14. Të realizojë, nëpërmjet Inspektoratit Sanitar Shëndetësor, inspektime periodike higjieno-sanitare të qendrave që akomodojnë viktimat e trafikimit, sipas një grafiku të hartuar paraprakisht mes Palëve.

F) Ministria e Arsimit dhe Shkencës:

1. Të zbatojë “Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit” të miratuar me VKM Nr. 582 datë

- 27.07.2011, aneks i kësaj Marrëveshjeje, për të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me intervistimin, identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
2. Të harmonizojë terminologjinë e të gjitha akteve të saj nënligjore të lidhura me viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit me VKM Nr. 582, datë 27.07.2011, aneks i kësaj Marrëveshjeje;
 3. Të sigurojë mbështetje për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit për regjistrimin në sistemin arsimor me kohë të plotë apo kohë të pjesshme dhe pajisje me literaturën përkatëse falas;
 4. Të sigurojë trajnimin e stafit pedagogjik mbi temat anti-trafikim;
 5. Të sigurojë integrimin e 2 (dy) orëve të detyrueshme në vit për tema të ndryshme në lidhje me trafikimin e personave në programet arsimore të arsimit 9-vjecar;
 6. Të sigurojë akses të Palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe OJF-ve që kanë ekspertizën e duhur në anti-trafikim për zhvillimin e aktivitete sensibilizuese në shkolla.

G) Qendrat (“Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit”, Qendra Psiko – Sociale “Vatra”, “Tjetër Vizion”, “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”):

1. Të zbatojnë “Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit” të miratuar me VKM Nr. 582 datë 27.07.2011, aneks i kësaj Marrëveshjeje, për të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me intervistimin, identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
2. Të respektojnë vullnetin dhe interesat e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe të bëjnë referimet përkatëse në përputhje me këtë parim. Në rastet e fëmijëve viktimat të trafikimit, interesat e fëmijëve do të kenë rëndësinë më të madhe gjatë procesit vendimmarrës;
3. Të respektojnë anonimatit dhe fshehtësinë e informacionit të dhënë nga personat e ndihmuar;
4. Të respektojnë standardet e miratuara dhe legjislacionin në fuqi në lidhje me asistimin dhe trajtimin e rasteve të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
5. Të ofrojnë një paketë të plotë të shërbimeve rehabilituese dhe ri-integruese në ndihmë të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe, në bashkëpunim edhe me ofrues të tjerë shërbimesh, të asistojnë edhe fëmijët e tyre nëpërmjet programeve të ri-integrimit, që përfshijnë shërbime rezidenciale dhe shërbime komunitare;
6. Të caktojnë një punonjës social të trajnuar për të marrë pjesë në pritjen fillestare dhe intervistimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, në bashkëpunim me strukturat e Policisë dhe Shërbimit Social Shtetëror, në të gjitha pikat e kalimit të kufirit dhe drejtoritë policore të qarqeve në të gjithë vendin;
7. Të sigurojnë transportin e viktimave për marrjen e shërbimeve të ndryshme në funksion të rehabilitimit dhe ri-integrimit të tyre në rast se përcaktohet se transportimi i tyre nuk përbën rrezik;
8. Të lehtësojnë kontaktet ndërmjet viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe familjeve të tyre dhe të ndërmjetësojnë, sipas rastit, për ribashkim familjar, kur kjo i shërben ri-integrimit të tyre social;
9. Të angazhohen të bashkëpunojnë me të gjitha institucionet në përputhje me VKM Nr. 582, datë 27.07.2011 “Për Miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit”, duke vendosur një partnership operativ;

10. Të ndjekin dhe monitorojnë progresin e viktimave në fazën e ri-integrimit në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror;
11. Të angazhohen në ndërgjegjësimin e publikut për pasojat e trafikimit dhe të drejtat e viktimave të trafikimit, si dhe në hartimin dhe koordinimin e programeve dhe aktiviteteve parandaluese të trafikimit të personave;
12. Të raportojnë në bazë tre-mujore pranë Autoritetit Përgjegjës dhe Koordinatorit Kombëtar Kundër Trafikimit të Personave mbi veprimtarinë e tyre anti-trafikim dhe sa herë të ketë informacion për raste të reja trafikimi, në përputhje me rregullat e shkëmbimit të informacionit dhe ruajtjes së konfidencialitetit dhe VKM-së Nr. 582, datë 27.07.2011 “Për Miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit”.

H) Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) – Tiranë:

Në përputhje me mandatin e saj dhe në varësi të disponueshmërisë së fondeve:

1. Të zbatojë “Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit” (PSV) të miratuara me VKM Nr. 582 datë 27.07.2011, aneks i kësaj Marrëveshjeje, për të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me intervistimin, identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
2. Të bashkëpunojë me Autoritetin Përgjegjës në identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit në përputhje me PSV-të, duke bashkëpunuar dhe koordinuar me zyrat e IOM në vende të ndryshme;
3. Të kontribuojë në forcimin dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve në zbatim të kësaj Marrëveshjeje;
4. Të kontribuojë në ngritjen e fondeve dhe burimeve për kthimin vullnetar të asistuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar në vendet e destinacionit;
5. Të kontribuojë në rehabilitimin dhe ri-integrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

I) Organizata Jo-Fitimprurëse ARSIS – Tiranë:

1. Të zbatojë “Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit” (PSV) të miratuara me VKM Nr. 582 datë 27.07.2011, aneks i kësaj Marrëveshjeje, për të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me intervistimin, identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
2. Të ketë në fokus fëmijët viktimë të trafikimit dhe të ofrojë në përputhje me statusin e tyre shërbime jo rezidencialerezidenciale dhe shërbim emergjence (deri në 72 orë);
3. Të vendosë punonjës social femra në pikat e kalimit kufitar, sipas mundësisë, për pritjen fillestare dhe intervistimin e përbashkët të personave të kthyer;
4. Të vërë në lëvizje të gjithë mekanizmin dhe aktorët përgjegjës për trajtimin e rastit për çdo rast fëmije të dyshuar apo të identifikuar si viktimë trafikimi apo në risk evident për t’u shndërruar në të tillë;
5. Të bashkëpunojë me Autoritetin Përgjegjës në identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit në përputhje me PSV-të;
6. Të kontribuojë në forcimin dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve në zbatim të kësaj Marrëveshjeje;

7. Të kontribuojë në ngritjen e fondeve dhe burimeve për kthimin vullnetar të asistuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar në vendet e destinacionit;
8. Të kontribuojë në rehabilitimin dhe ri-integrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit nëpërmjet vënies në lëvizje të ekipit të tij multidisiplinar të menaxhimit të rastit për trajtimin efektiv dhe ofrimin e të gjitha shërbimeve ri-integruese të nevojshme për fëmijën e referuar apo të identifikuar, të tilla si shërbim higjieno-sanitar, asistencë psiko-sociale apo asistencë administrativo-ligjore;
9. Të ofrojë ekspertizë dhe asistencë të drejtpërdrejtë në përgatitje dokumentacioni apo lehtësim pranë institucioneve të qeverisjes vendore apo qendrore;
10. Të kryejë referimin e rastit pranë shërbim-ofruesit të specializuar përgjegjës për trajtimin e problematikës të identifikuar, si qendra të ofrimit të shërbimit ligjor falas apo shërbim-ofrues të tjerë.

J) Organizata Ndërkombëtare “World Vision”:

1. Të zbatojë “Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit” (PSV) të miratuara me VKM Nr. 582 datë 27.07.2011, aneks i kësaj Marrëveshjeje, për të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me intervistimin, identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
2. Të ofrojë mbështetje për identifikimin e rasteve në rrezik ose rasteve të trafikimit në zonat ku World Vision vepron (Shkodër, Dibër, Lezhë, Kurbin, Durrës, Tiranë, Elbasan, Librazhd, Korçë, Vlorë);
3. Të bashkëpunojë me Autoritetin Përgjegjës në identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit në përputhje me PSV-të;
4. Të kontribuojë për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve në zbatim të kësaj Marrëveshjeje (Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, Administratorët Socialë, Strukturat e Policisë, Prokurorët, Komitetet Rajonale Antitrafik);
5. Të kontribuojë në ri-integrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
6. Të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet e trafikimit dhe mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal dhe kombëtar.

NENI 6

Siguria dhe konfidencialiteti i të dhënave personale

1. Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje shprehin detyrimin që të garantojnë nivelin më të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ata duhet të marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.
2. Palët nënshkruese, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje. Të dhënat nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.
3. Të gjitha Palët bien dakord që të dhënat të mbahen në Bazën Kombëtare të Dhënave për Viktimat e Trafikimit.

4. Autoriteti Përgjegjës duhet të përcaktojë një procedurë për shkëmbimin e informacionit për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit.
5. Autoriteti Përgjegjës harton rregulloren për ruajtjen e konfidencialitetit nga Palët dhe mbikëqyr ruajtjen e konfidencialitetit. Rregullorja e hartuar nga Autoriteti Përgjegjës për këtë qëllim bashkëlidhet me Marrëveshjen si aneks i saj.

NENI 7

Roli i Autoritetit Përgjegjës

1. Autoriteti Përgjegjës është struktura që do të udhëheqë zbatimin e Marrëveshjes lidhur me të gjitha rastet e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar dhe referuara në bazë të këtij Mekanizmi, në përputhje me PSV-të miratuar me VKM Nr. 582, datë 27.07.2011.
2. Struktura dhe funksionet e Autoritetit Përgjegjës përcaktohen në një urdhër të përbashkët të Palëve nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje.
3. Autoriteti Përgjegjës mblidhet në mënyrë periodike, të paktën një herë në muaj, por edhe më shpesh, në varësi të rasteve të referuara.
4. Autoriteti Përgjegjës raporton tek Koordinatori Kombëtar kundër Trafikimit të Personave në mënyrë periodike, një herë në tre muaj, por edhe më shpesh, sipas nevojës, për gjithë veprimtarinë e tij.
5. Për problematika të hasura gjatë zbatimit të Marrëveshjes, drejtuesi i radhës së Autoritetit Përgjegjës njofton me shkrim Koordinatorin Kombëtar kundër Trafikimit të Personave.

NENI 8

Monitorimi dhe bashkërendimi i Marrëveshjes

1. Monitorimi i zbatimit të Marrëveshjes kryhet nga Task Forca për Marrëveshjen, e cila drejtohet nga Koordinatori Kombëtar kundër Trafikimit të Personave. Task Forca për Marrëveshjen përbëhet nga një përfaqësues i lartë i secilës Palë nënshkruese të Marrëveshjes.
2. Njësia Antitrafik shërben si Sekretariat Teknik i Task Forcës për Marrëveshjen.
3. Task Forca për Marrëveshjen mblidhet rregullisht një herë në muaj për të shqyrtuar ecurinë e zbatimit të Marrëveshjes nën drejtimin e Koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit të Personave.
4. Me kërkesë të Autoritetit Përgjegjës ose Palëve nënshkruese, Task Forca për Marrëveshjen, mblidhet edhe më shpesh për të trajtuar raste të veçanta gjatë zbatimit të Marrëveshjes.
5. Palët informojnë në vazhdimësi Koordinatorin Kombëtar kundër Trafikimit të Personave për ecurinë e zbatimit të Marrëveshjes, si dhe për çdo problematikë apo vështirësi lidhur me të.

NENI 9

Buxheti

Të gjitha agjencitë, Palë të kësaj Marrëveshjeje, duhet të parashikojnë mjetet e duhura financiare për zbatimin e saj.

NENI 10

Anëtarësimi

Palë e kësaj Marrëveshjeje mund të bëhet çdo organizëm shtetëror dhe jo shtetëror që shpreh interesin për antarësim dhe që plotëson kriteret e mëposhtme:

1. kanë kapacitetet për të ofruar paketën e plotë të shërbimeve për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe asistencën e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit për të gjitha rastet e referuara nga Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje sipas PSV-ve;
2. kanë një përvojë prej pesë ose më shumë vitesh që ofrojnë specifikisht shërbime për trajtimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
3. paraqesin kërkesën me shkrim për t'u anëtarësuar si Palë në Marrëveshje para Koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit të Personave, kërkesë e cila, më pas, iu përcillet për shqyrtim dhe miratim unanim Palëve nënshkruese të Marrëveshjes;
4. detyrat e anëtarëve të rinj, që bëhen pjesë e këtij Mekanizmi, pasqyrohen në Nenin 5 të Marrëveshjes "Angazhimet e Palëve".

NENI 11

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim apo pretendim i dalë gjatë zbatimit të Marrëveshjes, përfshirë anulimin, shkeljen apo përfundimin e saj, do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet diskutimit dhe negociimit, ku do të përfshihen të gjitha Palët nën drejtimin e Koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit të Personave.

NENI 12

Ndryshimet

Ndryshimet apo shtesat e kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim, pas miratimit nga të gjitha Palët.

NENI 13

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas firmosjes nga të gjitha Palët e Marrëveshjes. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, shfuqizohet çdo marrëveshje tjetër për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat/Viktimat e Mundshme të Trafikimit të Personave.

NENI 14
Dispozita kalimtare

Palët nënshkruese të Marrëveshjes brenda një muaji nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, caktojnë përfaqësuesin e tyre të lartë si anëtar të Task Forcës për Marrëveshjen.

Palët Nënshkruese:

Për Ministrinë e Brendshme

Për Ministrinë e Punëve të Jashtme

Për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

Për Ministrinë e Shëndetësisë

Për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Për Prokurorinë e Përgjithshme

Për Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) - Tiranë

Për Organizatën Ndërkombëtare “World Vision” - Tiranë

Për Organizatën Jo-Fitimprurëse “ARSIS” – Tiranë

Për Organizatën Jo-Fitimprurëse “Të Ndryshëm dhe të Barabartë” – Tiranë

Për Qendrën Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit

Për Organizatën Jo-Fitimprurëse “Vatra” - Vlorë

Për Organizatën Jo-Fitimprurëse “Tjetër Vizion” - Elbasan

Tiranë, më __/__/2012

Aneksi 1

Procedurat Standarde të Veprimit Për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit